

V E N D I M
Nr. 384, datë 14.7.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.112, DATË 18.3.1999, “PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.4.1994, “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 18.3.1999, “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.3.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

A. Kreu II “**Shuma bazë e përfitimeve**” ndryshohet si vijon:

1. Në kuptim të neneve 2,32,36 dhe 48, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, shuma bazë e pensione nga data 1.7.2000 e në vazhdim është 5 148 lekë në muaj.

2. Në kuptim të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, niveli i pensionit, nga data 1.7.2000 e në vazhdim, është 1 328 lekë në muaj.

B. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

“Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2000 e në vazhdim, është 3 568 lekë”.

2. Fjalía e dytë, në pikën 2 ndryshohet si vijon:

“Për të punësuarit, punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 45.9 për qind të listëpagesave, në kufijtë e pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

3. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“Për vetëpunëdhënësit privatë dhe të vetëpunësuarit (duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhen kontribut të detyrueshëm në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

4. Paragrafi i dytë i pikës 4 ndryshohet si vijon:

“Punonjësit e paguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, me moshë mbi 16 vjeç, që nuk kanë ndonjë punësim tjetër, paguajnë kontribut të sigurimit shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim”.

5. Paragrafi i tretë i pikës 6 ndryshohet si vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë vetë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, një herë në tri muaj.”.

6. Paragrafi i fundit i pikës 6 ndryshohet si vijon:

“Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë, së bashku me kontributet e sigurimeve shoqërore, kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore në masën 5 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 45 lekë në muaj. Rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë, masën e kontributit e kanë 3 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 27 lekë në muaj.”.

7. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga data 1 korrik 2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta